

Fletë informuese 7:

HEC Fani përballet me përplasjet nga komuniteti dhe protesta për tjetërsimin e tokës.

| | |
|--|---|
| <p>Përshkrimi</p> | <p>Në vitin 2009, qeveria tenderoi koncesionin e Fanit të Madh dhe Fanit të Vogël në Pukë, rrethi i Mirditës për shfrytëzimin e kapaciteteve hidroenergjetike. Më 2 maj 2011, Ayen AS Energji nënshkroi kontratën e formës BOT nr. 5446 rep dhe nr. 1944 Kol me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë për ndërtimin dhe operimin e 3 hidrocentraleve me rrjedhje të lirë dhe një me digë përmes një koncesioni 35 vjeçar dhe kosto paraprake prej 142.5 milionë Euro. Më 20 dhjetor 2012, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit aprovoi ndërtimin e hidrocentraleve në lumenjtë ë Fanit të Madh dhe të Vogël. Punimet nisën në vitin 2013 dhe priten të përfundojnë në mes të vitit 2017-të. Banorët vendas në Qafë-Mollë (rrethi i Mirditës) kanë protestuar kundra ndërtimit të HEC-it, para se të kryhet kompensimi i tokës së tyre. Gjatë protestave banorët kanë shkatërruar asetet e kompanisë, kanë bllokuar punëtorët e kompanisë të hyjnë në kantier dhe janë ndeshur me forcat e policisë disa herë. 6 persona janë arrestuar për shkak të protestave. Më 30 korrik 2014 për shkak të një aksidenti brenda në tunel, kanë humbur jetën 3 punëtorë (2 shqiptarë + 1 turk), për shkak të shkatërrimit të tunelit gjatë ndërtimit. Si pasojë, 200 punëtorët e kompanisë të mbështetur dhe nga fshatarët e zonës kanë protestuar për kushtet e sigurisë në punë.</p> <p>Gjithashtu, banorët vendas në fshatin Gojan në Pukë janë përballuar në konflikt me partnerin tjetër shqiptar Ayen AS Energy, që çoi në shpërthimin e HEC-it Gojan duke shkaktuar një dëm prej 3 milionë EUR sipas deklaratave të kompanisë. Sipas komunikatave të policisë, dy persona të paidentifikuar kanë lidhur rojën e HEC-it dhe vendosën tritolin që shkaktoi shpërthimin.</p> |
| <p>Të dhëna kryesore</p> | <p>Ayen AS Energji shpk është një bashkim kompanish nga kompania turke Ayen Enerji Co, Inc, AyeI Elektrik Uretim Sanayi Ve Ticaret A.Ş., Fahrettin Amir dhe partnerëve shqiptarë AS Energy me 82%+8%+1% + 9% të aksioneve respektivisht.</p> <p>Dy hidrocentralet e parë, Gojan dhe Gjegjan do të përdorin ujin e sipërm të Fanit të Madh. Ndërsa dy të tjerët, Peshqesh dhe Ura e Fangut do të shfrytëzojnë kapacitetet hidroenergjetike të Fanit të Madh dhe të Fan-it të Vogël. Fani i Vogël, devijon brenda Fanit të Madh afër fshatit Shkoret, në komunën e Oroshit. Tre hidrocentralet e parë, FHP1, FHP2, dhe FHP3 janë me rrjedhje të lirë, ndërsa i katërti është me liqen dhe digë. Projekti i kaskadës së Fanit të Madh dhe të Vogël ka një kapacitet total, të instaluar prej 110.56 MW dhe një prodhim të parashikuar prej 367.640 Mwh ose ekuivalenti i 7% të kapacitetit aktual gjenerues në Shqipëri dhe 8% i energjisë së furnizuar në vend në vitin 2012. Projekti ka 8 turbina francis që lidhen së bashku me 3 faza dhe gjeneratorë të sinkronizuar.</p> |
| <p>Grafiku i marrë nga Kompania Ayen për qëllime studimore.</p> | |
| <p>Burimi i konfliktit</p> | <p>Tjetërsim i tokës – niveli i 1-rë i konfliktit, Punësimi lokal – niveli i 2-të i konfliktit, Mjedisi dhe burimet ujore – niveli i 3-të i konfliktit.</p> |
| <p>Detaje të projektit dhe aktorët</p> | <p>Ayen AS Energji</p> |
| <p>Zona e projektit</p> | <p>Rrethi i Mirditës Banorët lokalë nga Qafë-Molla</p> |
| <p>Niveli i investimit</p> | <p>Media lokale 13,600,000,000 –142.5 milion euro.</p> |

Fletë informuese 7:

HEC Fani përballlet me përplasjet nga komuniteti dhe protesta për tjetërsimin e tokës.

| | |
|--|--|
| Ndikimi i konfliktit | Dokumentuar dhe/ose potencial Ndikimi mjedisor: burimet ujore dhe pyjore të dëmtuar, shkatërrimi i peizazhit dhe devijimi i ujit. |
| | Dokumentuar Ndikimi socio-ekonomik: tjetërsimi i pronës, ndarja e ujit dhe vaditja e tokës. |
| Rezultati i konfliktit | Pjesërisht e ndërtuar, në ndërtim. Asnjë ndryshim institucional E pasigurtë. Projekti është në ndërtim e sipër. |
| Burime dhe materiale/Referencat | <ul style="list-style-type: none">- https://www.asp.gov.al/index.php/17-shqip/lajmet-e-fundit/9329-nga-seksioni-per-hetimin-dhe-parandalimin-e-krimeve-u-arrestuan-ne-flagrance-2-shtetas-gjeneralitetet-e-te-cileve-per-arsye-hetimi-nuk-jepen-per-vepen-penale-shkaterrimit-te-prones-me-eksploziv-kryer-ne-bashkepunim;- http://www.ayenas.al/project-description;- http://24-ore.com/?p=8631- http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/puk-shp-rthim-tritoli-n-hec-in-e-gjegjanit-autor-t-lidh-n-rojen-357845.html- Ekstrakt i kompanisë AS Energy në AKR. |